



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-071

Prishtinë, më 3 tetor 2016, në orën 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 3 TETOR 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Slobodan Petroviq, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri, Albulena Haxhiu, Pal Lekaj, Slavko Simiq dhe Valdete Bajrami.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Uran Ismaili dhe Avni Bytyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga NDI-ja: Rinor Beka dhe

Nga KDI-ja: Albert Krasniqi.

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës.

* * *

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 26 shtator 2016

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 26 shtator 2016.

* * *

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë për përgatitjen e rendit të ditës, për secilën pikë veç e veç, për seancën plenare të radhës, ai po ashtu tha nëse Projektligji për “Trepçën” procedohet nga Qeveria në Kuvend do të radhitet në rend të ditës për seancën plenare të radhës, e cila do të mbahet më 7 tetor 2016, me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Pastaj, kryetari e hapi diskutimin për caktimin e datës për mbajtjen e seancës plenare.

Lidhur me përgatitjet dhe propozimin e pikave të rendit të ditës për seancën plenare të radhës diskutuan: kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli; Ismet Beqiri, kryetar i GP të Lidhjes Demokratike të Kosovës; Albulena Haxhiu, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Zenun Pajaziti, kryetar i GP të Partisë Demokratike të Kosovës; Valdete Bajrami, kryetare e GP “Nisma për Kosovën”; Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit dhe Pal Lekaj, kryetar i GP të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se dy pikat e rendit të ditës, të bartura nga seanca plenare, e mbajtur më 29 shtator 2016: Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 05/106, datë 25. 8.2016, me të cilin konsiderohet interesi publik nga lëshimi i licencës për Projektin e Kompanisë Envidity Energy Kosova LLC dhe Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 06/106, datë 25. 8.2016, me të cilin konstatohet interesi publik për lëshimin e licencës për hulumtim për Projektin e Kompanisë Sharr Cem dhe Titan Amerika, mund të procedohen në ndonjërin nga seancat e radhës, pasi Komisioni Funkcional të konsultohet me Qeverinë e Kosovës.

* * *

Kryesia pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të premten, më 7 tetor 2016, në orën 15:00, me këtë rend dite:

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Trepçën,*
- 5. Votimi për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore,*
- 6. Votimi i Projektligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës,*
- 7. Votimi i Propozim-rezolutës lidhur me Kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës,*
- 8. Votimi i Propozim-rezolutës lidhur me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës,*
- 9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-117 për akreditim,*
- 10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përfaqësuesit,*
- 11. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës,*
- 12. Shqyrtimi i raportit për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2015,*
- 13. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2015.*

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 12:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*